

PROGRAMI PËR VLERËSIMIN E ARRITJEVE TË NXËNËSVE ME QËLLIM IDENTIFIKIMIN E NEVOJAVE PËR PËRMIRËSIM

KLASA VIII




Gjuhë shqipe
Matematikë
Gjuhë e huaj

TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES	1
HYRJE.....	2
REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE NË LËNDËN E GJUHËS SHQIPE	4
REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE NË LËNDËN E MATEMATIKËS.....	10
REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE NË LËNDËN E GJUHËS SË HUAJ	15

HYRJE

Institucionet arsimore në të gjithë botën janë duke u përballur me sfidat që solli pandemia COVID-19. I njëjti realitet është edhe në shkollat tona. Për të parandaluar përhapjen e virusit dhe për të siguruar shëndetin e mësuesve dhe të nxënësve, shkollat e realizojnë procesin mësimor mbi bazën e orientimeve të dhëna në Udhëzuesin për fillimin e vitit shkollor 2020-2021. Në këtë udhëzues parashikohen tre skenarë për zhvillimin e procesit mësimor:

-  mësim në shkollë;
-  mësim i kombinuar (në shtëpi dhe në shkollë);
-  mësim në kushtet e shtëpisë (online).

Këta skenarë janë zbatuar nga shkollat në varësi të infrastrukturës, të numrit të nxënësve dhe të situatës epidemiologjike. Mësimi në distancë ose i kombinuar ka bërë të mundur që pjesa më e madhe e nxënësve të vijojë normalisht me ndërtimin e njohurive dhe të aftësive lëndore, megjithatë ka pasur nxënës që për arsye të ndryshme (kanë kaluar COVID-19, nuk kanë pasur gjithmonë akses në internet, nuk ka qenë gjithmonë e mundur ndihma e prindërve, kanë nevojë për mbështetjen e mësuesit etj.), kanë pasur vështirësi në këtë proces.

Për të identifikuar vështirësitë dhe nevojat e nxënësve do të realizohen disa testime vjetore në lëndët kryesore. Këto teste janë *diagnostikuese*, nuk vlerësohen me notë dhe kanë për qëllim vetëm identifikimin e nevojave të nxënësve në lidhje me njohuritë dhe aftësitë kryesore të programeve mësimore.

Në klasën e tetë do të zhvillohen dy teste:

- Gjuhë shqipe dhe Matematikë (ky test do të jetë i përbashkët për të dyja lëndët)
- Gjuhë e huaj

Për të orientuar hartuesit e testeve, mësuesit dhe drejtuesit e shkollave është hartuar programi për vlerësimin e arritjeve të nxënësve në lëndët “Gjuhë shqipe”, “Matematikë” dhe “Gjuhë e huaj”. Këto lëndë zhvillojnë te nxënësit kompetencat më të rëndësishme, të cilat janë jo vetëm kusht për nxënien e të gjitha lëndëve në shkollë, por edhe për suksesin në jetë dhe në tregun e punës. Hartimi i këtij programi është mbështetur në programet e gjuhës shqipe, të matematikës dhe të gjuhës së huaj për klasën e tetë dhe përfshin njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme që duhet të zotërojnë nxënësit.

Programi ka tri pjesë:

1. Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave në lëndën e gjuhës shqipe
2. Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave në lëndën e matematikës
3. Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave në lëndën e gjuhës së huaj

Përdoruesit e programit janë:

- specialistët e vlerësimit në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA), të cilët do të bazohen në këtë program për hartimin e testeve;
- mësuesit, të cilët do t'i përdorin rezultatet e testit për identifikimin e vështirësive të nxënësve dhe për planifikimin e punës në lidhje me përmirësimin e arritjeve;
- drejtuesit e shkollave, të cilët do të koordinojnë dhe do të monitorojnë procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve dhe përmirësimin e tyre.

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE NË LËNDËN E GJUHËS SHQIPE

Njohuritë	Rezultatet e të nxënit
Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare	
	<p>Të lexuarit për të kuptuar tekstin ¹</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - interpreton tekstet dhe jep argumente që mbështesin interpretimin e tij; - zgjeron kuptimin mbi tekstet duke lidhur idetë në to me idetë dhe njohuritë e tij; - dallon faktin nga opinioni; - dallon shkakun nga pasojat; - dallon problemin dhe zgjidhjen e problemit; - analizon marrëdhëniet mes pjesëve të tekstit; - gjykon për vlerat e një teksti duke përdorur ilustrime dhe detaje nga teksti; - nxjerr konkluzione pasi ka lexuar dhe ka kuptuar një tekst; - tregon se si ndikon teksti në botën emocionale ose në ndjesitë e tij; - dallon fjalët e huaja dhe i zëvendëson me fjalë shqipe (kur fjala përgjegjëse është në gjuhën shqipe).
<p>Tekste letrare</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nxënësi punon (njeh, kupton, interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson) me tekste poetike, tekste në prozë dhe tekste dramatike nga 	<p>Të lexuarit e teksteve letrare</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan kohën, vendin, mjedisin dhe ngjarjet, duke dhënë detaje nga teksti;

¹ Këto rezultate janë të përbashkëta për tekstet letrare dhe jo letrare.

letërsia shqipe dhe nga letërsia botërore.

- Tema dhe motivet
- Hiperbola, alegoria, antiteza

Teksti poetik

- Tiparet e metrikës në poezi (lloji i vargut, i rimës dhe i strofës).
- Tiparet kryesore të disa teksteve poetike, si: balada, soneti, himni, elegjia etj.

Teksti në prozë

- Tiparet e disa teksteve në prozë, si: tregimi, novela dhe romani, përralla etj. si p.sh; fabulave (*personazhet, personifikimi, alegoria, morali i fabulës*); përrallave (*elementet fantastike, numërorët: 3,7,9,12, formulat e hyrjes dhe të mbylljes, personazhet joreale, formulat e magjisë, fundi i lumtur, hiperbola etj.*).

Teksti dramatik

- Tiparet kryesore të tragjedisë, komedisë dhe dramës.

- dallon dhe shpjegon funksionin e hiperbolës, alegorisë, antitezës.

Teksti poetik

- diskuton rreth atmosferës që krijon poezia;
- dallon motivet në një tekst poetik;
- dallon tiparet e metrikës në poezi (lloji i vargut, i rimës dhe i strofës);
- dallon disa lloje të teksteve poetike, si: balada, soneti, himni, elegjia etj., si dhe tiparet kryesore të tyre;
- përcakton disa tipare të baladës, sonetit, himnit, elegjisë etj.

Teksti në prozë

- rrëfen, me detaje nga teksti, subjektin e një proze;
- dallon temën dhe motivet;
- përcakton tipare të disa teksteve në prozë, si: tregimi, novela dhe romani, përralla etj.

Teksti dramatik

- përcakton tiparet kryesore të tragjedisë, komedisë dhe dramës, si dhe përcakton ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre;
- dallon dhe analizon elementet e strukturës së një teksti dramatik si: skena, aktet, personazhet, fjalët e personazheve, didaskalitë;
- analizon tiparet e personazhit letrar në bazë të ngjarjeve, të dialogut dhe të monologut.

<p>Tekste jo letrare</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tiparet kryesore të teksteve: biografi, kujtime, reportazhe, kronika, ese të ndryshme, reklama. - Fakti dhe opinioni. 	<p>Të lexuarit e teksteve jo letrare</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lexon tekste si: biografi, kujtime, reportazhe, kronika, ese të ndryshme, reklama; - dallon argumentet pro dhe kundër një çështjeje në një tekst; - dallon një tekst letrar nga një tekst joletrar si p.sh., krahason një roman me një biografi ose autobiografi, një tregim fantastiko-shkencor nga një udhëpërshkrim etj.
<p>Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale</p>	
	<p>Procesi i të shkruarit</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - identifikon qëllimin e tij kur shkruan një tekst; - zgjedh formën e duhur të detyrës me shkrim në varësi të qëllimit që ka; - mbështet mesazhin kryesor të një teksti me detaje përshkruese, me fakte ose me shembuj të ndryshëm; - respekton strukturën e punës me shkrim (hyrje, zhvillim, mbyllje); - përdor gjatë të shkruarit gjuhën standarde dhe respekton rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore; - bën ndryshime në punën me shkrim për të përmirësuar përmbajtjen dhe qartësinë e tekstit, si dhe drejtshkrimin.
<p>Të shkruarit për qëllime personale</p>	<p>Të shkruarit për qëllime personale</p> <p>Nxënësi:</p>

<ul style="list-style-type: none"> - Shkrimi i një tregimi fantastiko-shkencor duke u mbështetur në imagjinatën e nxënësve. - Komente rreth një poezie. - Rrëfime personale. 	<ul style="list-style-type: none"> - shkruan rrëfime personale duke përshkruar ose reflektuar mbi veten, përvojat personale, ngjarjet e kaluara etj.; - shkruan tregime për tema që janë interesante për moshën; - realizon shkrime komentuese për poezi të ndryshme.
---	--

<p>Të shkruarit për qëllime funksionale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ese 	<p>Të shkruarit për qëllime funksionale</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shkruan ese.
--	---

Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës

<p>Sintaksë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Funksionet gramatikore të fjalëve në fjali (kryefjalë, kallëzues, përcaktor, rrethanor, kundrinor). - Fjalitë e përbëra me nënrenditje. - Llojet e fjalisë së përbërë me nënrenditje. - Ligjërata e drejtë dhe e zhdrejtë. Kthimi i ligjëratës së drejtë në ligjëratën e zhdrejtë (ndryshimet që ndodhin). 	<p>Sintaksë</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon funksionet gramatikore të fjalëve në fjali (kryefjalë, kallëzues, përcaktor, rrethanor, kundrinor) dhe tregon me se shprehen; - dallon fjalitë e përbëra me nënrenditje; - përcakton llojin e fjalisë së përbërë me nënrenditje; - dallon ligjëratën e drejtë nga e zhdrejta; - kthen ligjëratën e drejtë në ligjëratë të drejtë dhe anasjelltas.
--	---

<p>Morfologji</p> <p><i>Mbiemri</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Kategoritë gramatikore të mbiemrit <p><i>Përemri</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Përemri lidhor - Përemri pronor 	<p>Morfologji</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - analizon mbiemrin dhe kategoritë e tij gramatikore; - dallon dhe përdor në fjali përemrin lidhor; - dallon dhe përdor në fjali përemrin pronor;
--	--

<p><i>Folja</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Zgjedhimi jovepror në mënyrat: dëftore, habitore, lidhore, kushtore, dëshirore dhe urdhërore <p><i>Ndajfolja</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Llojet e ndajfoljeve dhe shkallët e tyre <p><i>Parafjala</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Parafjalët sipas strukturës morfologjike 	<ul style="list-style-type: none"> - dallon dhe përdor foljet në formën joveprore, në mënyrat: dëftore, lidhore, habitore, kushtore, dëshirore dhe urdhërore; - gjen dhe përdor ndajfoljet - përcakton shkallët e ndajfoljeve; - tregon se si ndryshon një ndajfolje në shkallë të ndryshme; - dallon dhe përdor në fjali parafjalët.
<p>Fjalëformim</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fjala dhe pjesët e saj përbërëse. - Analiza e fjalëve sipas ndërtimit dhe formimit. 	<p>Fjalëformim</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon dhe analizon fjalën dhe pjesët e saj përbërëse; - analizon fjalët sipas ndërtimit dhe sipas formimit.
<p>Drejtshkrim</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përdorimi i saktë i dy pikave, thonjzave, pikëpresjes dhe kllapave. - Përdorimi i drejtë i fjalëve që fillojnë me bashkëtingëlloret sh-, zh-, ç-nistore. - Përdorimi i drejtë i grupeve të bashkëtingëlloreve mb, ng, nd, ngj. - Shkrimi i ligjëratës së drejtë dhe të zhdrejtë. 	<p>Drejtshkrim</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor saktë dy pikat, thonjëzat, pikëpresjen dhe kllapat; - shkruan drejt fjalët që fillojnë me bashkëtingëlloret sh-, zh-, ç-nistore; - shkruan drejt grupet e bashkëtingëlloreve mb, ng, nd, ngj; - shkruan drejt ligjëratën e drejtë dhe të zhdrejtë.

Leksikologji dhe semantikë

- Kuptimi i parë dhe kuptimi i figurshëm i fjalëve.
- Dialektet e gjuhës shqipe dhe vlera e tyre.
- Gjuha standarde, roli dhe rëndësia e përdorimit të saj.

Leksikologji dhe semantikë

Nxënësi:

- përcakton kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalëve dhe kuptimin e figurshëm;
- vlerëson pasurinë leksikore të dialekteve të shqipe;
- vlerëson gjuhën standarde, rolin dhe rëndësinë e saj.

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE NË LËNDËN E MATEMATIKËS

Njohuritë	Rezultatet e të nxënit
Tematika: Numri	
Numrat e plotë, fuqitë dhe rrënjët <ul style="list-style-type: none"> - Simbolet e fuqisë dhe rrënjës. - Fuqitë me eksponent 2 dhe 3. - Rrënja katrore dhe kubike. 	Numrat e plotë, fuqitë dhe rrënjët <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor simbolet e fuqisë dhe të rrënjës; - llogarit fuqitë me eksponent 2 dhe 3; - llogarit rrënjën katrore dhe rrënjën kubike.
Vendvlera, krahasimi dhe rrumbullakimi <ul style="list-style-type: none"> - Rrumbullakimi i shumëfishave të dhjetës, në fuqi të plotë të dhjetës (p.sh., 10, 100, 1000; 200, 3000 etj.). - Rrumbullakimi i nënfishave të dhjetës me një ose dy shifra mbas presjes në fuqi të plotë të dhjetës (p.sh. 0.1, 0.01; 0.3; 0.04 etj.). 	Vendvlera, krahasimi dhe rrumbullakimi <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - rrumbullakos shumëfishat e dhjetës, në fuqi të plotë të dhjetës (p.sh., 10, 100, 1000; 200, 3000 etj.); - rrumbullakos nënfisha të dhjetës me një ose dy shifra mbas presjes në fuqi të plotë të dhjetës (p.sh. 0.1, 0.01; 0.3; 0.04 etj.).
Thyesat, numrat dhjetorë, përqindja, raporti dhe përpjesëtimi <ul style="list-style-type: none"> - Thyesa të barabarta me numra dhjetorë dhe përqindje. - Renditja e thyesave duke gjetur emëruesin e përbashkët ose duke i kthyer në numra dhjetorë. - Përqindja, rritjen apo ulja e përqindjes. - Numri kur është dhënë pjesa ose përqindja e tij. 	Thyesat, numrat dhjetorë, përqindja, raporti dhe përpjesëtimi <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - gjen thyesa të barabarta me numra dhjetorë dhe përqindje duke i këmbyer ato me njëra-tjetrën; - rendit thyesat duke gjetur emëruesin e përbashkët ose duke i kthyer në numra dhjetorë; - llogarit përqindjen, rritjen apo uljen e

<ul style="list-style-type: none"> - Raporte dhe përpjesëtimi i drejtë. 	<p>përqindjes;</p> <ul style="list-style-type: none"> - gjen numrin kur është dhënë pjesa ose përqindja e tij; - ndan një sasi në dy pjesë sipas një raporti të dhënë.
<p>Veprimet e mbledhjes, zbritjes, shumëzimit dhe pjesëtimit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbledhja dhe zbritja e numrave të plotë dhe numrave dhjetorë e thyesave dhe numrave të përzierë. - Shumëzimi dhe pjesëtimit i numrave me shenjë. - Shumëzimi dhe pjesëtimi i numrave dhjetorë me 0,1 dhe 0,01. - Shumëzimi dhe pjesëtimi i numrave dhjetorë me një shifër pas presjes. - Shumëzimi dhe pjesëtimi i një numër të plotë me një thyesë. - Radha e veprimeve përfshirë kllapat në shprehje 	<p>Veprimet e mbledhjes, zbritjes, shumëzimit dhe pjesëtimit</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - mbledh dhe zbret thyesat dhe numrat e përzierë; - shumëzon dhe pjesëton numrat me shenjë; - shumëzon dhe pjesëton numrat dhjetorë me 0,1 dhe 0,01; - shumëzon pjesëton numrat dhjetorë me një shifër pas presjes; - shumëzon dhe pjesëton një numër të plotë me një thyesë; - përdor radhën e veprimeve përfshirë kllapat në shprehje numerike.
Tematika: Matja	
<p>Gjatësia dhe masa</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njësitë e gjatësisë dhe masës. 	<p>Gjatësia dhe masa</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zgjedh njësitë e përshtatshme të gjatësisë dhe masës për të vlerësuar, matur, llogaritur, zgjidhur situata problemore në kontekste të ndryshme nga jeta reale.
<p>Perimetri, syprina dhe vëllimi</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përkufizimi i rrethit dhe elementeve të tij. - Formulatat për perimetrin dhe syprinën 	<p>Perimetri, syprina dhe vëllimi</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njeh përkufizimin e rrethit dhe emërton

<p>e rrethit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Formulatat për syprinën e trekëndëshit, paralelogramit dhe trapezit. 	<p>elementet e tij;</p> <ul style="list-style-type: none"> - njeh dhe përdor formulatat për perimetrin dhe syprinën e rrethit; - nxjerr dhe përdor formulën për syprinën e trekëndëshit, paralelogramit dhe trapezit.
--	---

Tematika: Gjeometria

<p>Gjeometria në plan</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kongruenca e trekëndëshave - Këndi i jashtëm i një trekëndëshi. - Vetitë e drejtëzave dhe këndeve. - Vetitë e trekëndëshave dhe katërkëndëshave. - Mesorja dhe përmesorja e segmentit. - Përgjysmorja e këndit. - Ndërtimi i një trekëndëshi kur janë dhënë tre brinjët; një kënd i drejtë, hipotenuza dhe një katet. 	<p>Gjeometria në plan</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njeh kongruencën e trekëndëshave; - identifikon që këndi i jashtëm i një trekëndëshi është i barabartë me shumën e dy këndeve të brendshëm të trekëndëshit jo të bashkëmbështetur me të; - përdor vetitë e këndeve dhe drejtëzave prerëse, paralele dhe pingule në situata të ndryshme problemore; - përdor vizore trekëndësh dhe kompas për të ndërtuar mesoren dhe përmesoren e segmentit si dhe përgjysmoren e këndit; - përdor një vizore dhe kompas për të ndërtuar një trekëndësh kur janë dhënë tre brinjët; një trekëndësh kur janë dhënë një kënd i drejtë, hipotenuza dhe një katet.
<p>Gjeometria në hapësirë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Trupat gjeometrikë si: kuboidi; prizmi, piramida. 	<p>Gjeometria në hapësirë</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vizaton rrjete të trupave gjeometrikë si: kuboidi; prizmi, piramida
<p>Shndërrime gjeometrike dhe sistemi koordinativ</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mesi i segmentit $[AB]$, kur janë dhënë 	<p>Shndërrime gjeometrike dhe sistemi koordinativ</p>

<p>koordinatat e pikave A dhe B.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Simetria, rrotullimi dhe zhvendosja e figurave 2D. - Zmadhimi (zvogëlimi), qendra dhe koeficienti i zmadhimit (zvogëlimit). 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - gjen mesin segmentit $[AB]$, kur janë dhënë koordinatat e pikave A dhe B; - transformon një figurë 2D nëpërmjet simetrisë, rrotullimit dhe zhvendosjes si dhe nëpërmjet kombinimeve të thjeshta të tyre; - zmadhon (zvogëlon) figura 2D kur është dhënë qendra dhe koeficienti (numër pozitiv) i zmadhimit (zvogëlimit).
---	---

Tematika: Aljebra dhe funksioni

<p>Shprehjet shkronjore, ekuacionet dhe formulat</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlera e shprehjeve shkronjore; - Veprimet në shprehjet shkronjore (reduktime, shndërrime). - Ekuacione të fuqisë së parë me një ndryshore, me koeficientë numra të plotë (e panjohura mund të jetë nga njëra në e barazimit ose nga të dyja anët) me ose pa kllapa. 	<p>Shprehjet shkronjore, ekuacionet dhe formulat</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njehson vlerën e shprehjeve shkronjore; - redukton ose shndërron shprehjet shkronjore me koeficientë numra të plotë; - formon dhe zgjidh ekuacione të fuqisë së parë me një ndryshore, me koeficientë numra të plotë (e panjohura mund të jetë nga njëra në e barazimit ose nga të dyja anët) me ose pa kllapa.
<p>Vargu, funksioni dhe grafik</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vargu numerik dhe rregulli i formimit të tij. - Funksione të thjeshta lineare ($y=ax+b$). - Ekuacioni i drejtëzës $y = ax + b$. 	<p>Vargu, funksioni dhe grafik</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - gjeneron kufiza në një varg me një rregull të caktuar duke lidhur pozicionin e kufizës me kufizën ose kufizat me njëra - tjetrën; - gjen kufizat ose pozicionin e kufizës në një varg të dhënë sipas një rregulli; - shpreh funksione të thjeshta lineare dhe i paraqet ato me diagram ($y=ax+b$);

	<ul style="list-style-type: none"> - ndërton tabelat e vlerave dhe përdor koordinatat për të ndërtuar grafikun e tyre; - njeh që ekuacioni i drejtëzës $y = ax + b$ shpreh grafikun e një funksioni linear.
Tematika: Statistika dhe probabiliteti	
Grumbullimi, organizimi, interpretimi dhe përpunimi i të dhënave	Grumbullimi, organizimi, interpretimi dhe përpunimi i të dhënave
<ul style="list-style-type: none"> - Tabela e dendurive për të dhëna diskrete dhe të vazhdueshme. - Mesorja, moda dhe mesatarja aritmetike për të dhënat diskrete dhe të vazhdueshme. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ndërton dhe përdor tabelën e dendurive për të dhëna diskrete dhe të vazhdueshme; - llogarit mesoren, modën dhe mesataren aritmetike për të dhënat diskrete dhe të vazhdueshme.
Probabiliteti	Probabiliteti
<ul style="list-style-type: none"> - Probabiliteti i ngjarjes së kundërt ($1 - p$). - Probabiliteti i ngjarjeve të thjeshta me rezultate njësoj të mundshme. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - gjen probabilitetin e ngjarjes së kundërt ($1 - p$); - gjen probabilitetin e ngjarjeve të thjeshta me rezultate njësoj të mundshme në situata praktike.

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE NË LËNDËN E GJUHËS SË HUAJ

Njohuritë	Rezultatet e të nxënit
Të lexuarit dhe të kuptuarit e një teksti të shkruar	
<p>Përshkrimi: Nxënësi kupton tekste të shkurtër të hartuar kryesisht me fjali të thjeshta dhe me fjalor të njohur që flasin për jetën e përditshme familjare dhe shkollore dhe botën që e rrethon.</p>	
<ul style="list-style-type: none"> - Shkolla dhe familja - Preferencat personale - Njerëz të famshëm - Mënyra e të jetuarit - Jeta e adoleshentëve - Filmat, librat, muzika - Shkenca - Bota që na rrethon 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lexon tekste që flasin për jetën e njerëzve të famshëm; - kupton një mesazh të thjeshtë, si sms, e-mail etj.; - kupton letra personale të thjeshta ku përshkruhet mënyra e jetesës së adoleshentëve; - dallon të dhëna personale në një pyetësor; - identifikon mesazhe, komente të thjeshta mbi detyrat dhe punën e bërë; - lexon dhe kupton tekste të thjeshta mbi muzikën, filmat dhe librat; - dallon informacionin bazë dhe disa detaje në një tregim që trajton temë të njohur me fjalor përgjithësisht të trajtuar më parë; - identifikon mesazhin kyç në njoftime, faqe interneti etj.; - identifikon informacionin specifik në broshura dhe artikuj të shkurtër gazetash ku përshkruhen ngjarje.
Përdorimi i drejtë i gjuhës	
<p>Përshkrimi: Nxënësi përcjell mesazhin me shkrim nëpërmjet strukturave të mësuara gramatikore duke i përdorur ato saktë dhe pa gabime ortografike.</p>	
<ul style="list-style-type: none"> - Koha e shkruar e thjeshtë - Koha e shkruar e vazhduar 	<p>Nxënësi:</p>

- Kohët e tashme të thjeshta dhe të përbëra
- Lidhëzat dhe fjalët lidhëse
- Fjalëformimi

Fjalitë kushtore

- dallon dhe formon fjali të thjeshta dëftore, pyetëse, në kohën e tashme dhe të shkuar;
- përdor folje të rregullta dhe të parregullta, në kohën e tashme dhe të shkuar;
- përdor korrekt lidhëzat dhe fjalët lidhëse;
- përdor mbiemrat cilësorë, pronorë, dëftorë etj.;
- përdor fjali të thjeshta kushtore (e tashme dhe e shkuar).

Të shkruarit


Përshkrimi: Nxënësi shkruan tekste përshkrues, letra ose emaile personale mbi tema të jetës së përditshme. Nxënësi përdor fjali dhe shprehje të thjeshta duke përdorur lidhëza dhe fjalë lidhëse të ndryshme.

- Shkrimi i një letre ose emaili personal mbi tema të njohura nga jeta e përditshme.
- Shkrimi i një përmbledhjeje të shkurtër për një libër ose film.
- Përshkrimi i njerëzve, objekteve, vendeve etj.

Nxënësi:

- shkruan një mesazh, një letër ose një email personal duke përdorur formula mirësjelljeje;
- përshkruan në një letër personale familjen, vendin ku banon, kohën, veprimtaritë e ndryshme që kryen;
- përshkruan një person duke dhënë detaje për veshjen, pamjen e jashtme etj.;
- përshkruan itinerarin e një udhëtimi;
- përshkruan shokë, miq, të afërm, personazhe, objekte, sende e kafshë të dashura për të;
- përshkruan thjesht atë që i ka ndodhur në një të shkuar të largët ose të afërt.

**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**



Rruga "Naim Frashëri"
Nr. 37
Tiranë
Shqipëri

(+355) 4256440 / 4256441

sekretaria@ascap.edu.al

www.ascap.edu.al